

BILANCI I PRODUKTEVE AGROUSHQIMORE SI BAZË E POLITIKAVE QEVERTITARE

BALANCE OF AGRICULTURAL AND FOOD PRODUCTS AS A BASE FOR GOVERNMENT POLICIES

Mujë GJONBALAJ, Halim GJERGJIZI
Fakulteti i Bujqësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakti

Politikat tregtare të cilat duhet të ndiqen nga ana e institucioneve qeveritare të Kosovës për mbështetjen e prodhimit për treg të produkteve agroushqimore janë objekt i diskutimeve dhe i debateve me vite në mes të ekonomistëve kryesisht kosovarë dhe vendimmarrësve politikë ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Në qendër të debateve janë dy strategji zhvillimore të sektorit të produkteve agro-ushqimore, njëra e zëvendësimit të importeve të produkteve agroushqimore të cilat mund të prodhohen në vend dhe tjetra të zhvillimit sipas epërsisë krahasuese, më qëllim të eksportimit të një numri të produkteve konkurruese në tregun ndërkombëtar, ku Kosova ka epërsi krahasuese në prodhim.

Me përcaktimin e statusit politik të

Kosovës, do të ketë nevojë të rishqyrtohet strategjia zhvillimore e këtij sektori, i cili konsiderohet si më i rëndësishmi në ekonominë e Kosovës.

Për përcaktimin e politikave tregtare qeveritare do të jetë e domosdoshme përcaktimi i bazës statistikore dhe metodologjike. Roli i këtyre politikave do të jetë vendimtarë për nxitjen e zhvillimit të sektorit agro-ushqimorë në Kosovë.

Në këtë punim do të fokusohemi në ndërtimin e bilancit të përgjithshëm dhe bilancit tregtarë të produkteve agroushqimore të zgjedhura për analizë, duke vënë në pah tepricat dhe mungesat bilancore të produkteve përkatëse. Bilancet duhet t'u shërbejnë institucioneve përkatëse për marrjen e vendimeve efektive, në përkrahje me prioritet të zhvillimit të produkteve

me deficit më të theksuar.

Vlerësimet lidhur me bilancet do të prezantohen në terma absolute dhe për kokë banori. Shqyrtimet dhe analizat e bilanceve të produkteve agroushqimore në këtë punim shtrihen në periudhën e fundit dhjetëvjeçare 1995-2005, si dhe parashikimet deri në vitin 2013, duke u mbështetur mbi praktikat dhe metodologjitë relevante shkencore e profesionale.

Fjalë kyçe: produkte agroushqimore, zëvendësimi i importeve, epërsia krahasuese, Kosova, politikat qeveritare.

Hyrje

Bilancet e produkteve agroushqimore në këtë punim trajtohen si elemente të rëndësishme të analizave dhe i përcaktimit të politikave të ndërhyrjes së shtetit në stabilizimin e zhvillimit të sektorit bujqësorë.

Bilancet e produkteve agroushqimore paraqesin në mënyrë analitike raportin në mes të prodhimit dhe të nevojave për produkte agroushqimore në periudha të ndryshme kohore, zakonisht në nivel të vendit. Varësisht dhe në bazë të këtyre raporteve, institucionet qeveritare ndermarrin masa për ta mbuluar deficitin apo duke përdorur suficitin e produkteve.

Për shkak të mungesës së një metodologjie të përcaktuar dhe për

mungesë të shënimeve statistikore, në Kosovë ende nuk përgatiten bilancet e produkteve agroushqimore si bazë analitike e politikave qeveritare. Ndërsa në shumë vende dhe institucione ndërkombëtare ekzistojnë modele dhe udhëzime të tilla (Michael Tracy, 1993).

Në Kosovë në një periudhë afatgjate raporti në mes prodhimit dhe nevojave për konsum të produkteve agroushqimore është shprehur përmes deficitit të lartë të një numri të madh produktesh. Deficiti zakonisht është mbuluar me importin e sasive të konsiderueshme të produkteve agroushqimore. Politikat liberale në import kanë favorizuar mbulimin e deficitit përmes importit duke lënë anash aktivitetet fermere dhe rritjen e prodhimit vendore. Në anën tjetër, rritja e importit ka shkaktuar ngritjen e çmimeve në tregun e vendit si dhe shkapërderdhje të mëdha financiare (investimeve). Në mungesë të bilanceve të nevojave të produkteve agroushqimore importet janë realizuar mbi nevojat reale edhe duke rezikuar prodhimin vendas.

Në periudhën e pasluftës në Kosovë konkurrenca e pakontrolluar e produkteve agroushqimore të importuara nga jashtë ka rrënuar në masë të konsiderueshme aktivitetin prodhues vendas.

Politikat agroushqimore kanë për qëllim nxitjen e zhvillimit të sektorit agroushqimor në një vend dhe të krijojnë hapsira për konkurrencë korrekte

me produktet e importuara. Çdo propozim i politikave, nga ana e qeverisë, duhet të bazohet në analizat e problematikës së prodhimit dhe konsumit të produkteve agro-ushqimore, respektivisht të balanceve të produkteve agroushqimore.

Bilancet e produkteve agroushqimore paraqesin pikënisje për politikat qeveritare me qëllim të shtimit të prodhimit të ushqimit, përdorimit më produktiv të tokave bujqësore, zbatimit të politikave ushqimore, stabilizimit të politikave të çmimeve të produkteve bujqësore, rregullimit të politikave të importit dhe të eksportit, mbështetjes së prodhimit përmes politikave kreditore, të politikave të marketingut, të politikave të ekstensionit dhe të kërkimeve etj.

Në bazë të treguesve të balanceve agroushqimore, përcaktohen edhe qëllimet dhe mënyrat e ndërhyrjes qeveritare, nisur nga objektivi i maksimizimit të përfitimit shoqëror duke përdorur në mënyrë efektive resurset e kufizuara në bujqësinë e vendit.

Politikat dhe programet agroushqimore në Kosovë duhet të ofrojnë një koncept të ri zhvillimor. Në qendër të debateve janë dy strategji zhvillimore të sektorit të produkteve agro-ushqimore, njëra e zëvendësimit të importeve të produkteve agroushqimore të cilat mund të prodhohen në vend dhe tjetra të zhvillimit sipas epërsisë krahasuese, më qëllim të eksportimit të një numri të produkteve konkurruese

në tregun ndërkombëtar, ku Kosova ka epërsi krahasuese në prodhim.

Konteksti i zhvillimit agroushqimor të Kosovës

Kosova është një vend me ekonomi të vogël, të pazhvilluar dhe midis vendeve më të varfra në Evropë. Ritmet e rritjes të parametrave makroekonomikë janë të pavolitshme. Prodhimi Bruto në vitin 2005 ishte 2.238 milion € dhe 1.120 € për çdo banor. Të dhënat preliminare për vitin 2006 dhe parashikimet për vitin 2007 parashohin¹ rritje simbolike të PB-së dhe rënie të vogël për çdo banor. Rritja e planifikuar e PB-së vjen nga një bazë shumë e ulët. Sektori privat është rritur 1,7% krahasuar me vitin paraprak. Treguesit e varfërisë dhe të papunësisë po përkeqësohen. Varfëria ka tendencë rritjeje. Rreth 45% e popullsisë jetojnë në varfëri, 18% jetojnë në kufirin e varfërisë dhe 15% jetojnë në varfëri të skajshme. Norma zyrtare² e papunësisë është 42%.

Bujqësia është sektor i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës, i cili i kontribon në PB-së me 20% dhe punësimit të përgjithshëm me rreth 25-30%. Ky sektor veçohet me produktivitet të ulët, ku dominojnë fermat ekzistenciale.

Pjesëmarrja e lartë e bujqësisë në krijimin e PB-së dhe të punësimit, dëshmojnë për ngecjet³ dhe çrregullimet e mëdha në ekonominë e Kosovës, për efektivitetin e ulët të sektorit bujqësorë dhe për kontributin e vogël të indus-

trisë dhe sektorëve tjerë të rëndësishëm të ekonomisë. Edhe pse Kosova është vend agrar ku rreth 2/3 e popullsisë jeton në rajone rurale dhe disponon burime të favorshme natyrore, ajo nuk është në gjendje të sigurojë produkte bujqësore në sasi të mjaftueshme nga prodhimtaria vendore⁴.

Pjesa më e madhe e këtyre produkteve sigurohen nga importi pa ndonjë ndërhyrje të institucioneve për moslejimin e importit të produkteve që prodhohen në vend. Në të shumtën e rasteve, kryesisht për shkak të presionit të komunitetit vendor të prodhuesve, institucionet qeveritare kur tentojnë të ndërhyjnë, ata nuk kanë analiza të duhura se në çfarë niveli duhet ndërhyrë që të mos rrezikohet rritja e çmimeve nga mungesa e produkteve në treg.

Në Kosovë asnjëherë nuk është prodhuar ushqim i mjaftueshëm dhe përherë ekzistonte nevoja për importe për përmbushjen e nevojave të popullsisë. Në vitet 80, ajo i plotësonte nevojat për ushqim me 30-50%. Eksportet e përgjithshme arrinin vlerën rreth 220 milionë dollarë dhe vetëm produktet ushqimore 45-50 milionë dollarë. Pas rreth dy dekadave vlera e eksporteve është disa herë më e vogël (72 milionë euro në vitin 2006). Struktura e eksporteve sipas mallrave është e ngjajshme, por sasi të mallrave të përfshira në eksport janë në sasi më të vogëla.

Eksportet kryesore përbëheshin nga verërat, perimet dhe frutat e freskëta,

kërpudhat dhe frutat e konservuara. Këto vite eksportoheshin mesatarisht 50-60.000 qingja dhe bagëti të tjera të gjalla në BE, kryesisht në Greqi, Gjermani dhe Zvicër.

Bujqësia përbën një kontribut të rëndësishëm në tregtinë e jashtme të Kosovës. Në vitin 2005 bujqësia i kontribuoi me 16% eksportit dhe 25% importit të përgjithshëm. Importet bujqësore në vitin 2005 ishin rreth 280 milionë euro. Eksportet kryesore të produkteve agroushqimore ishin pijet (pjesa më e madhe vera), perimet e frutat e freskëta dhe perimet e përpunuara. Importet kryesore agroushqimore janë pijet, ëmbëlsirat dhe qumështi i përpunuar.

Aktualisht, dhe gjatë gjithë viteve të pasluftës, pjesa më e madhe e ofertës së përgjithshme të ushqimit vjen nga importet. Rreth 80% e nevojave për mish, 25% për vezë dhe perime, 50% për fruta dhe shumë artikuj të tjerë ushqimorë.

Përmirësimi i bilancit tregëtar dhe i parametrave të tjerë makroekonomikë varet nga zhvillimi i ardhshëm i ekonomisë së Kosovës dhe në mënyrë të veçantë nga integrimi efektiv në tregun botëror. Eksportet, që tani janë më pak se 5%, duhet të rriten për të financuar importet, por edhe për të nxitur prodhimin vendor, krijimin e të ardhurave dhe punësimin.

Kosova do të vazhdojë të ketë nevojë për importe të konsiderueshme për t'u zhvilluar. Por, Kosova me përparësi

ka nevojë të identifikojë sektorët dhe produktet me fuqi konkurruese, financimin e importeve përmes eksporteve, sepse dërgesat e emigrantëve kosovarë nga jashtë dhe sidomos asistenca e jashtme, po ulen nga viti në vit. Meqë kapaciteti prodhues është i kufizuar, është shumë vështirë të jepen gjykime rreth sektorëve që kanë potencialin më të madh për zhvillim. Nga studimet e realizuara si dhe duke u bazuar në strukturën ekzistuese të burimeve dhe faktorëve të bujqësisë, duket se sektori agroushqimor do të ketë mundësinë më të mirë për rritje të eksportit.

Në Kosovë janë rreth 100 mijë ferma bujqësore. Pjesa dërmuese e tyre prodhojnë për nevojat vetjake dhe vetëm rreth 10% janë ferma tregëtare dhe gjysëm tregëtare. Prodhimi bujqësor vetjak zë 73% të perimeve dhe deri 96% të frutave.

Pronat e vogla mesatarisht me 2,5 ha tokë bujqësore për fermë, përdorimi jo produktiv i tokës dhe mjeteve të tjera, kostoja e lartë e prodhimit për shkak të çmimeve të larta të inputeve, të cilat vijnë kryesisht nga importi, arsimimi i ulët i fermerëve për teknologji dhe biznes bashkëkohor, kushtëzojnë politika të reja të informacionit dhe të teknologjive të prodhimit.

Pavarësisht nga rënia e pjesëmarrjes në krijimin e PB-së (rreth 50% në vitin 1999-2000), bujqësia mbetet burim me rëndësi i pasurisë kombëtare dhe sektori më i madh i punësimit (145.000 njerëz).

Gjendja aktuale në zhvillimin e bujqësisë së Kosovës

Si rezultat i luftës, shumë ferma mbetën të zbrazëta, sepse përfitimi ekonomik është i ulët dhe mungojnë inputet. Infrastruktura dhe faktorët e tjerë bujqësorë u dëmtuan rëndë, në disa raste janë shkatërruar plotësisht. Kapacitetet e ujitjes kanë rënë në masë drastike, nga rreth 88.000 ha në rreth 23.000 ha, për shkak të mosmirëmbajtjes dhe dëmtimeve të luftës. Rreth 50% e bagëtisë dhe 40% e stallave, 30-45% e traktorëve, autokombajnave dhe makinave të tjera u shkatërruan ose humbën. Vlera e shkatërrimeve dhe humbjeve rurale u vlerësua nga institucionet ndërkombëtare në rreth 737 milion dollarë amerikanë⁵.

Si rrjedhojë fshati dhe bujqësia janë varfëruar tej mase. Familjet kosovare në zonat rurale realizojnë fare pak të ardhura nga bujqësia. Sipas anketave vetëm 8,6% e tyre krijojnë të ardhura dhe sigurojnë ekzistencën nga bujqësia. Familjet e tjera, që jetojnë në zonat rurale, sigurojnë ekzistencën, të ardhurat dhe punësimin jashtë bujqësisë, në institucione publike apo private, nga ndihmat sociale, dërgesat nga të afërmit, nga emigracioni etj.

Fermat e vogla, shërbimi i dobët këshillimor, qasja e vështirësuar në kredite, infrastruktura e varfër, njohuri të pakta lidhur me teknikat e reja të prodhimit dhe teknikat e menaxhimit të fermave bujqësore, të përcjella nga produktiviteti dhe të ardhurat e

ulëta, janë karakteristikë kryesore e bujqësisë kosovare.

Komplekset e mëdha që dikur ishin bartëse të aktivitetit prodhues, përpunues dhe eksportues të produkteve agroushqimore, janë dëmtuar shumë nga pikëpamja e menaxhimit gjatë kohës së pushtimit serb dhe u dëmtuan mjaft nga lufta. Në fakt, shumë pak nga këto ndërmarrje vazhdojnë të prodhojnë ose eksportojnë diçka. Në të njëjtën kohë, sektori i vogël privat është shumë më i angazhuar në aktivitetet shërbyese, ngase duket më i lehtë fitimi nëpërmjet tregtisë me pakicë se sa prodhimi për eksport.

Aktualisht, struktura e shfrytëzimit të sipërfaqeve të punueshme është e orientuar për sigurimin e drithërave, si bazë e ushqimit të popullsisë. Në meset e caktuara, ku ka kushte për ujitje fermeret janë të orientuar gjithnjë e më shumë në prodhimin e perimeve.

Shumica e fermave punojnë për të siguruar ekzistencën për familjen. Vetëm rreth 10% e tyre arrijnë të prodhojnë për treg. Kështu ndodh edhe për shkak të rendimenteve tejet të ulëta të kulturave kryesore bujqësore (rreth 50% më të ulëta nga niveli optimal) si dhe për shkak të praktikave tradicionale siç janë shkalla e lartë e mbjelljes me farëra, aplikimi i varieteteve më pak produktive apo mospërdorimi i herbicideve dhe praktikat jo aq efektive të menaxhimit.

Politikat qeveritare të UNMIK-ut dhe të Qeverisë së Kosovës

Me përfundimin e luftës në vitin 1999, Kosova administrohet nga UNMIK-u ⁶. Gjendja e ndërmarrjeve bujqësore dhe agroushqimore u keqësua edhe më tepër nga pasojat e veprimeve luftarake. Disa objekte si ai i fermës së bojlerëve në Gllogovc me kapacitet prej 7,5 milion bojlerë në vit u bombardua pa mundësi riparimi, kurse shumë reparte të prodhimit për një kohë të gjatë u shndërruan në vendqëndrime të KFOR-it. Me kthimin e punëtorëve në vendet e tyre të punës, kudo në ndërmarrjet shoqërore u pa një gjendje shumë e rëndë tekniko-teknologjike dhe financiare. Paisjet ishin shumë të dëmtuara. Arkat e ndërmarrjeve, në të gjitha rastet ishin plaçkitur.

Në këto përpiqje, grupet udhëheqëse u ballafaquan me shumë probleme, sidomos të natyrës financiare. Mosfunksionimi i sistemit bankar iu bëri të pamundur ndërmarrjeve çfarëdo hapi drejt rifillimit të aktivitetit.

Mallrat e ndërmarrjeve kosovare, si vaji, mielli, materiali ndërtimor, barnat mjekësore dhe shumë artikuj të tjerë nuk bliheshin sepse organizatat humanitare filluan ti sjellin këto mallra nga jashtë.

Ashpërsimit të problemeve ekonomike në Kosovë i kontribuan mjaft politikat e UNMIK-ut, më vonë edhe zgjidhjet jo racionale të institucioneve vendore (politikat makroekonomike, vonesat në privatizim, problemet e

furnizimit me energji, problemet me shërbime të PTT-së, shërbimet hekurdhore etj. Këto politika ekonomike dhe mungesa e mekanizmave përkatës, po reflektojnë negativisht, në formë më të ashpër në proceset zhvillimore të sektorit agroushqimor.

Si rrjedhojë e këtyre politikave, oferta vendore e produkteve agro-ushqimore është shumë e varfër. Tregu i Kosovës aktualisht furnizohet shumë pak nga prodhuesit kosovarë. Importimi i produkteve agroushqimore me çmime të larta nga Serbia dhe vendet e tjera është bërë praktikë e zakonshme.

Meqë në strukturën e shpenzimeve të buxhetit familjar në Kosovë ushqimi merr pjesë me rreth 60%, atëherë ushqimi i importuar edhe më tepër e rrezikon atë. Në këtë mënyrë derdhen shuma të konsiderueshme të mjeteve për produkte të cilat mund të sigurohen në Kosovë. Vlerësohet se për importin e produkteve bujqësore-ushqimore shpenzohen në vit së paku 300 milion € ose rreth 30% të të gjitha importeve.

Me shtimin e popullsisë janë duke u shtuar edhe kërkesat për ushqim si në sasi ashtu edhe në cilësi. Prodhimtaria e tanishme e ushqimit nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat në rritje për ushqim në Kosovë. Në bazë të ecurive të deritashme, gjendja dhe rrjedhat e sigurimit të ushqimit në Kosovë mund të vlerësohet si shumë e pavolitshme me tendencë të përkeqësimit të mëtejshëm. Puna dhe jeta në fshat më tepër

është një mënyrë e jetesës se sa një aktivitet i mirëfilltë ekonomik.

Kjo gjendje është rezultat edhe i politikave injoruese të UNMIK-ut dhe i neglizhencës së institucioneve kosovare. Pasojat ndihen kudo, papunësia vetëm sa po thellohet, sikur edhe varfëria, migrimi i popullsisë në relacionin fshat-qytet nuk ka të ndalur.

Edhe pse Kosova është një vend agrar me shumë potenciale favorizues për prodhimin e ushqimit, deficitin për këto produkte po thellohet. Disa nga masat e ndërmarra të politikave fiskale bujqësore (Këshilli Ekonomik Fiskal) në vitin 2004, nuk kanë reflektuar në përmirësimin e gjendjes së fermerëve, në rritjen e aftësisë prodhuese dhe përmirësimin e aftësisë konkurruese.

Kosova është importues gati 100% i shumicës së artikujve ushqimorë, të cilat vijnë nga shtetet ku paguhen subvencione në prodhim apo në eksportet e produkteve bujqësore. P.sh. kërkesa e vlerësuar për grurë plotësohet me 57% nga prodhimtaria vendore. Pjesa tjetër e grurit vjen kryesisht nga Serbia. Fermat Kosovare përmbushin 76% të kërkesave vendore për qumësht dhe produkte të tij; pjesa tjetër mbulohet nga importi, kryesisht nga Hungaria, Sllovenia dhe Kroacia. Nevojat për mish plotësohen vetëm rreth 19% nga prodhimi vendor dhe 81% importohet, kryesisht nga Brazili, Polonia dhe nga SHBA-ja. Prodhimi lokal i vezëve plotëson rreth 74% të kërkesës, i frutave të freskëta rreth 80%, i frutave të

përpunuara më pak se 10%, i perimeve të freskëta 75% etj. Importet kryesisht vijnë nga Maqedonia dhe Turqia.

Prodhuesit kosovarë, detyrohen që të përballen me produktet e subvencionuara⁷. Përsa i përket eksportit në Kosovë⁸, Sllovenia subvencionon koshin dhe Hungaria djathin.

Nga importet e përgjithshme të Kosovës, nga vendet e CEFT-ës vijnë 46%, ndërkaq eksportet kosovare në këto vende arrijnë 56% (12% nga Shqipëria). Importet në Kosovë dhe eksportet nga Kosova në vendet e BE-së në vitin 2006 arrijnë në 31%.

Roli i bilanceve të produkteve agrorëshqimore

Bilancet e produkteve agrorëshqimore kanë rëndësi parësore për vendimmarrësit në institucionet qeveritare dhe joqeveritare ngase ato përcaktojnë nivelin e disponibilitetit të produkteve, për të cilat duhet të ndermerren masa qoftë për mbulimin e deficitit, qoftë për përdorimin e suficitit⁹.

Bilancet e produkteve agrorëshqimore nga aspekti përmbajtësor janë të ndryshme. Dallojmë bilancet e përgjithshme dhe ato tregtare. Bilancet e përgjithshme kanë për qëllim pasqyrimin e gjendjes së përgjithshme, përfshin prodhimin dhe konsumin e produkteve në vend.

Në anën e sasive të disponueshme janë rezervat fillestare dhe prodhimi, që paraqet sasinë e gjithëmbarshme që prodhohet brenda vitit në vend. Në

anën e nevojave për produktin kemi konsumin e popullsisë, konsumin për industrinë e përpunimit dhe sasinë të cilat përdorën për të ushqyer blegtorinë, përdorimin e produktit për farë dhe humbjet nga kalbja apo dëmtimi nga format tjera. Dallimi midis këtyre kategorive është suficitit apo deficitit i produkteve përkatëse ushqimore.

Bilanci tregëtar ka një përfshirje më të gjerë të elementeve nga sfera e tregëtimit të produktit. Dallojmë dy pjesë të këtij bilanci: sasinë e disponueshme të produktit dhe sasinë e nevojave për produktin.

Në pjesën e sasisë së disponueshme marrin pjesë rezervat fillestare dhe sasia komerciale e prodhimtarisë, pra sasia e cila i destinohet tregut. Në pjesën e nevojave për produktin marrin pjesë sasinë e produktit të cilat tregëtohen në treg dhe rezervat përfundimtare. Ndryshimi paraqet suficitin apo deficitin në bilancin e produkteve ushqimore.

Për të siguruar të dhëna të sakta mbi bilancin, përkatësisht sasinë e produkteve agrorëshqimore, duhet të shfrytëzohen njëkohësisht të dhënat për bilancin e përgjithshëm dhe atë tregtar.

Me përdorimin e të dhënave të dy llojeve të bilanceve mund të konkludohet gjendja në sigurimin e përgjithshëm të ushqimit në vend, për të identifikuar qartë edhe sasinë e produkteve, që janë të disponueshme për konsumatorët në treg. Në bazë të këtyre bilanceve, përpiluesi i politikave bujqësore fare lehtë mund të propo-

zojë masa mbrojtëse apo mbështetëse.

Baza statistikore për bilancin e përgjithshëm sigurohet nga statistikat e vendit mbi sasinë e produktit në fillim të vitit apo rezervat me të cilat hyn vendi në një vit kalendarik. Sasia e prodhimit, e grurit dhe e artikujve të tjerë nga tabela 1, sigurohet nga shënimet statistikore mbi prodhimin e produkteve bujqësore gjatë viteve përkatëse.

Shënimet mbi pjesën e dytë të bilancit, pra për nevojat sigurohen nga shënimet statistikore (konsumi për njerëz, për industri, blegtori, rezervat përfundimtare) ose nga normativat mbi përdorimin e produkteve (fara, humbjet). Shënimet mbi konsumin e produkteve agroushqimore i gjejmë në anketat statistikore mbi konsumin e kategorive të ndryshme të popullsisë (shih tabelën 2).

Baza statistikore për bilancin tregëtar sigurohet gjithashtu nga statistikat e vendit mbi sasinë e produktit në fillim të vitit apo rezervat me të cilat hyn vendi në një vit kalendarik.

Sasia e grumbulluar e grurit nga tabela 3, vjen nga shënimet statistikore të blerjes me shumicë të grurit nga fermerët, nga tregëtarët, mullinjtë apo kooperativat. Shënimet mbi shitjet nga pjesa e dytë e bilancit vjen nga burimet statistikore mbi shitjen e grurit respektivisht të miellit dhe produkteve të miellit me shumicë dhe pakicë.

Nga bilancet e prezantuara të grurit mund të konkludohet se bilanci tregtar në disa vite është më deficitar

(negativ) se sa bilanci i përgjithshëm. Kjo ndodh për shkak të nivelit të ulët të tregëtimit të tepricave/grumbullimit të kulturës bujqësore.

Pasqyrimi real i balanceve të produkteve agroushqimore, i lehtëson, por njëkohësisht i detyron institucionet qeveritare të ndërmarrin masa në disa drejtime si:

- Rritja e prodhimitarisë vendore duke stimuluar përdorimin e farërave më produktive dhe inputeve të tjera cilësore,
- Stimulimi i grumbullimit të tepricave të produkteve bujqësore përmes kreditimit të ndërmarrjeve grumbulluese etj.
- Aktivizimi i politikave fiskale, të importit dhe të eksportit me qëllim stabilizimin e tregut vendor të produkteve agroushqimore dhe të eksportimit, sidomos nga prodhimtaria vendore.

Pse shteti duhet të ndërhyjë në sektorin agroushqimor

Shteti ndërhy në sektorin agroushqimor me qëllim të eliminimit të mangësive në tregjet e produkteve, rregullimit të çështjes së të drejtës të pronësisë mbi tokën, krijimit të kushteve për rritjen e të ardhurave bujqësore, stabilitetit të tregjeve, rritjes efektive të prodhimit bujqësor, sigurisë ushqimore dhe problemeve mjedisore etj.

Në bujqësinë kosovare me vite janë grumbulluar probleme të ndryshme të cilat pengojnë zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm të ekonomisë.

MUJË GJONBALAJ, HALIM GJERGJIZI

TAB 1. Bilanci i përgjithshëm i grurit (ton) në Kosovë 2001-2006

Elementet/viti	2001	2002	2003	2004	2005	2006
I. DISPONIBEL	264,819	257,330	243,199	207,555	280,846	293,046
1. Rezervat fillestare	15,600	17,805	18,799	19,793	20,787	21,781
2. Prodhimi	249,219	239,525	224,400	187,762	260,059	271,265
II.NEVOJAT	475,415	444,259	409,053	379,874	385,723	402,246
1.Humbjet	7,477	7,186	6,732	5,633	7,802	8,138
2.Fara	27,600	27,450	26,573	16,038	14,730	22,800
3.Ushqim për kafshë	32,398	31,138	29,172	24,409	33,808	35,264
4.Ushqim për njerëz	387,840	366,055	327,376	325,144	322,783	320,443
1.Rezervat përfundimtare	20,100	12,430	19,200	8,650	6,600	15,600
III.TEPRICAT/MUNGESAT	(210,596)	(186,929)	(165,854)	(172,319)	(104,877)	(109,200)
IV.PLASMANI I TEPRICES	-	-	-	-	-	-
V.IMPORTI	210,596	186,929	165,854	172,319	104,877	109,200

Burimi: Vlerësim i autorëve

TAB 2. Konsumi vjetor i produkteve agrourbimore (kg/banorë) në Kosovë në periudhen 2001-2006

Produktet/viti	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Grurë	192	179	158	155.2	152.4	149.6
Oriz	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5	2.5
Patate	67.3	69.4	72.1	75	76.2	77
Fasule	5.5	5.3	5.1	5.045	4.9	4.7
Perime	112	126	135	146	149	151
Fruta	25	25.5	28	30	32	33
Mish	35.4	36.8	38	40.9	42	44
Vezë (kokra)	158	166	178	200	210	213
Qumësht (lt)	126	154	158	160	165	168
Sheqer	15	16.6	17.1	18	18.1	18.4
Yndyrë	3.1	3	2.8	2.7	2.62	2.59
Vaj (lt)	11	13	14.6	15.8	16	16.6

Burimi: Vlerësim i autorëve

Bilanci i produkteve agrourbimorë si bazë e politikave qeveritare

TAB 3. Bilanci tregëtar i grurit në Kosovë

Elementet/viti	2001	2002	2003	2004	2005	2006
I. DISPONIBEL	40,522	46,548	47,971	46,080	59,796	65,183
1. Rezervat fillestare	65,183	17,805	18,799	19,793	20,787	21,781
2. Grumbullimi	24,922	28,743	29,172	26,287	39,009	43,402
II. NEVOJAT	219,465	223,231	226,997	230,763	234,529	238,295
1. Shitjet	201,660	204,432	207,204	209,976	212,748	215,520
2. Rezervat përfundimtare	17,805	18,799	19,793	20,787	21,781	22,775
III. TEPRICAT/MUNGESAT	(178,943)	(176,683)	(179,026)	(184,683)	(174,733)	(173,112)
IV. PLASMANI I TEPRICES						
V. IMPORTI	178,943	176,683	179,026	184,683	174,733	173,112

Burimi: Vlerësim i autorëve

Gjendjen në bujqësinë kosovare më së miri e ilustron bilancet e produkteve agrourbimorë në të kaluarën por edhe ato të projektuara për periudhën deri në vitin 2013.

Problemet kryesore në sektorin agrourbimor të Kosovës janë:

- (a) Riorganizimi i subjekteve ekonomike në shfrytëzimin e burimeve natyrore të kufizuara;
- (b) Shtimi i ushqimit për nevojat e tregut të brendshëm dhe të jashtëm,
- (c) Zhvillimi rural efektiv.

Të tre problemet janë të ndërlydhura në mes veti dhe nevojiten politika afatgjate dhe efektive për eliminimin e problemeve zhvillimore të sektorit agrourbimor.

Në kuadër të tregut liberal, çfarë është tregu agrourbimor në Kosovë, ndërlyrja e shtetit është i domosdoshëm për të krijuar një balancë të re në mes të shtetit dhe tregut, me qëllim të zhvillimit afatgjatë dhe të qendrueshëm të sektorit agrourbimor.

Si rezultat i politikave liberale në

import dhe mungesës të mbështetjes së prodhimitarëve vendore, në vitin 2006 importi i Kosovës kishte një vlerë prej 1.242 milionë euro, ndërsa eksporti arrinte vlerën prej 71,2 milionë euro, ndërsa mbulesa eksport-import në atë periudhë ishte 5,7%. Pjesëmarrja e produkteve agrourbimorë në importimin e mallrave është rreth 30%.

Si pasojë e politikave liberale tregëtare vijnë disa efekte negative e pasoja afatgjate:

- (a) Zvogëlimi permanent i ofertës së produkteve vendore si rezultat i kostos së lartë të prodhimit,
- (b) Zvogëlimi i të ardhurave të fermerëve nga aktiviteti bujqësor,
- (c) Zvogëlimi i të ardhurave të konsumatorëve për të blerë produkte agrourbimorë në treg.

Ndërlyrja e shtetit për rritjen e ofertës vendore zakonisht ka për objekt rritjen e të ardhurave të fermerëve, zëvendësimin e importeve dhe shtimin e prodhimit për eksport. Politikat e UNMIK-ut dhe të Qeverisë së Kosovës kanë qenë dhe mbështetës si shumë liberale.

Si rezultat i një politike të tillë të mos mbështetjes së prodhimitarisë vendore, vëllimi dhe struktura e ofertës së produkteve agrourbushqimore në Kosovë është dobësuar dukshëm, sepse prodhimtaria vendore nuk arrin të jetë konkurruese me produktet e importuara.

Një pjesë e popullsisë së Kosovës, sidomos ajo e varfër¹⁰ nuk ka të ardhura të mjaftueshme për blerjen e ushqimit. Çmimet e larta ulin edhe më shumë fuqinë e tyre blerëse, duke rezultuar në këtë mënyrë me pasiguri ushqimore për familjet e varfra. Kjo gjendje kërkon që politika e sigurisë ushqimore në Kosovë të fokusohet në sigurimin e ushqimit të mjaftueshëm për të varfërit dhe jo vetëm tek disponibiliteti i ushqimeve në treg. Ky është një kusht i nevojshëm për sigurinë ushqimore por ai nuk është i mjaftueshëm.

Riformulimi i rolit të institucioneve qeveritare në Kosovë

Dëmtimi i burimeve natyrore në Kosovë me vite është një problem shqetësues me pasoja afatgjate. Ndërtimet në tokën produktive bujqësore, dëmtimi i biodiversitetit, ndotja dhe shpërdorimi i ujit kërkojnë përcaktimin e politikave afatgjata për një zhvillim të qëndrueshëm.

Në bujqësinë kosovare janë të domosdoshme ndërhyrjet e institucioneve qeveritare për rritjen e komercializimit të produkteve të fermës, ofrimit të shërbimeve të konsulencës, të informacionit, përmirësimit të infrastrukturës

rurale, subvencionimit sikur po vepronjë shtetet fqinje, ndërhyrjes në tarifatat doganore, të mbështetjes së eksportit, ngritjes së sistemit statistikorë modern, hulumtimet shkencore dhe profesionale, duke krijuar qendrën e dokumentacionit të dhënave dhe të projekteve.

Funksionimi i statistikave për bujqësi, ka rëndësi parësore për përgatitjen e bazave analitike dhe bilancore si kusht për përcaktimin e politikave efektive zhvillimore të bujqësisë kosovare dhe për futjen e saj në rrjedhat integruese evropiane dhe botërore. Efektet e politikave qeveritare në bujqësi janë të ndryshme. Ato varen nga fakti se sa janë të bazuara në analiza përkatëse.

Efektet e ndërhyrjeve qeveritare në bujqësi mund të shprehën në:

- Çmime,
- Prodhim,
- Konsum,
- Tregëti,
- Shpenzime publike,
- Rishpërndarje dhe mjedis

Shumica e këtyre kategorive mund të rindahen në kategori më të ulëta.

Disa përfundime kryesore

Bilancet e produkteve agrourbushqimore kanë rëndësi parësore për institucionet qeveritare dhe joqeveritare ngase ato përcaktojnë nivelin e disponibilitetit të produkteve për të cilat duhet të ndërmerren masa, qoftë për mbulimin e deficitit qoftë për përdorimin e suficitit.

Përmirësimi i bilanceve të përgjith-

shme dhe atyre tregëtare të produkteve agroushqimore kërkon nga Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u të vazhdojnë me përkushtim zhvillimin e reformave të filluara, në mënyrë të veçantë integrimin efektiv të Kosovës në tregun e gjerë dhe institucionet relevante botërore.

Në bazë të ecurive në bilancin e produkteve agroushqimore në Kosovë, është e domosdoshme ndërhyrja e shtetit me qëllim eliminimin e mangësive në sferën e prodhimit, përmirësimin e shërbimeve këshillimore dhe të marketingut bujqësor.

Në kuadër të zhvillimit afatgjatë agrar të Kosovës duhet të identifikohen përparësitë krahasuese për programe fitimprurëse dhe të pranuar në tregun e vendit dhe të jashtëm.

Zhvillimi efikas agrar duhet të realizohet edhe përmes ndikimit të politikave aktive ndërsektoriale të zhvillimit, përmirësimit dhe zgjerimit të infrastrukturës rurale dhe të forcimit të institucioneve publike.

Shënime

1. Burimi: World Bank (2006): Kosovo Poverty Update. Vol. 1, f. 2.
2. Pjesëmarrja e bujqësisë në krijimin e PB-ë, sipas vendeve ishte: 23% në Shqipëri, 13% në Serbi dhe Turqi, 12% në Maqedoni 11% në Ukrainë, 6% në Rusi, 5% në Poloni, 3% në Australi, 2,3% në Kanada dhe UE, 1,6% në SHBA. Shih më gjerësisht: World Bank(2006): Kosovo Poverty Update, f. 64.
3. Po aty, f. 10.
4. Për krahasim 1,6% e popullësisë së SHBA

e cila merret me prodhimin e ushqimit arrin të prodhojë ushqim të mjaftueshëm për rreth 280 milion banorë dhe të eksportoji sasi të konsiderueshme të këtyre produkteve.

5. *Libri i Gjellbër i Kosovës*, MBPZHR, Prishtinë, 2003

6. Deri para suprimimit të autonomisë së Kosovës, ekzistonin në të gjitha nivelet e strukturës shtetërore Kuvendi, qeveria, Sistemi gjyqësor, sistemi i sigurimit, mbrojtja territoriale, sekretariatet(ministritë) etj. Gjatë regjimit serb ekzistonte guvernatori i Qeverisë së Serbisë për administrimin e Kosovës.

7. Serbia paguan subvencione 6 cent/litër për qumështin e eksportuar në Kosovë; Sllovenia subvencionon qumështin "Alpsko" që eksportohet në Kosovë me 2.5 cent/litër dhe kosin me 4.25 cent/litër. Bullgaria subvencionon djathin e bardhë që eksportohet në Kosovë me 19 cent/kg, Hungaria me 11.5 cent/kg, 65 cent për kg djathin gjysmë të fortë "Trappista". Efekti i përgjithshëm i këtyre subvencioneve është se zvogëlon koston e djathit me 11-65 cent/kg, qumështit me 2.5 cent dhe kosit me 4 cent. Propozimi i MBPHR (dhjetor 2004), për të subvencionuar me 5 cent çdo litër qumësht të prodhuar për treg (asnjëherë nuk është realizuar).

8. Vizitoni webfaqen e PPB-së në <http://www.eur-export.com/anglais/apptheo/logistique/douane/PrincipesPolDouA.htm>

9. Krahas bilancit sasior ekziston edhe bilanci i kalorive dhe i proteinave të cilat janë të nevojshme për funksionet jetësore të organizmit.

10. Sipas Bankës Botërore, 47% e popullsisë së Kosovës konsiderohet e varfër, 18% rrezikojnë të bien në këtë kategori dhe 15% jetojnë në varfëri të skajshme (shih më gjerësisht studimin: *Kosovo Agricultural Expenditure Review*, Maj 2007)

Bibliografi

- MBPZHR, *Plani për zhvillimin rural dhe bujqësor 2007-2013*, Prishtinë, 2007.
- MBPZHR, *Libri i Gjellbër i Kosovës*,

Prishtinë, 2003.

Kosovo Agricultural expenditure review, Karin Foch (World Bank Consultant), ECSSD, maj 2007.

Tracy, Michael. *Food and agriculture in a market economy (An Introduction to Theory, Practice and Policy)*, 1993.

A Comprehensive survey of agriculture and agribusiness. France, 2000.

Gjergjizi, Halim. *Probleme të strukturimit të ekonomisë rurale në kuadrin e proceseve të transformimit të ekonomisë së Kosovës*, (disertacion doktorature), Tiranë, 2004.

Gjonbalaj, M. *Ndikimi i faktorëve ekonomikë dhe demografikë në zhvillimin e popullsisë së Kosovës* (monografi), Prishtinë, 1997